



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1784/114 Prot.

Pogradec, më 05.05.2026

VENDIM

NR. 62, DATË 30.04.2026

PËR
RISHQYRTIMIN E TARIFAVE TË ADMINISTRIMIT PËR NDËRTESAT
QË DO TË ADMINISTRUJEN NGA SHOQËRIA POGRADECI INVEST
SHPK.

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; shkronjës "F" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shteterore dhe enteve publike"; neni 35 i Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; pika 2 e nenit 32 të Ligjit nr. 55/2025, "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa"; Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; me propozim të shoqërisë Pogradeci Invest Shpk dhe Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratohen tarifat e administrimit për ndërtesat në bashkëpronësi që do të administrohen me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec nga shoqëria Pogradeci Invest Shpk, të detajuara si më poshtë:

1.1 TARIFAT E ADMINISTRIMIT PËR NJËSITË E BANIMIT /MUAJ:

Nr.	KATEGORIA E PALLATIT	SHËRBIMET E PËRFSHIRA	TARIFAT MUJORE /NJËSI BANIMI
1	Pallat pa ashensor	Pastrim i ambienteve të përbashkëta (2herë/javë) ndriçim, mirëmbajtje e zakonshme, riparime të vogla, lyerje 1(një)herë në 2 (dy)vjet .	500 lekë
2	Pallat me ashensor (pa kontratë mirëmbajtje ashensori)	Pastrim i ambienteve të përbashkëta (2herë/javë) ndriçim, mirëmbajtje e zakonshme, riparime të vogla, lyerje 1(një)herë në 2 (dy)vjet .por pa përfshirë	500 lekë



		mirëmbajtjen e ashensorit	
3	Pallat me ashensor (me mirëmbajtje të zakonshme)	Pastrim i ambienteve të përbashkëta (2herë/javë) ndriçim, mirëmbajtje e zakonshme, riparime të vogla, lyerje 1 (një) herë në 2 (dy) vjet, kontroll dhe mirëmbajtje e rregullt teknike e ashensorit.	1 000 lekë
4	Pallat me ashensor (me mirëmbajtje full kasko të ashensorit)	Pastrim i ambienteve të përbashkëta (2herë/javë) ndriçim, mirëmbajtje e zakonshme, riparime të vogla, lyerje 1 (një) herë në 2 (dy) vjet, kontroll dhe mirëmbajtje e rregullt teknike e ashensorit, përfshirë ndërhyrje urgjente, realizim defektesh	1 500 lekë

1.2 TARIFAT E ADMINISTRIMIT PËR NJËSITË E SHËRBIMIT/MUAJ

Nr.	POZICIONI I NJËSISË SË SHËRBIMIT	SHËRBIMET E PËRFSHIRA	TARIFAT MUJORE /NJËSI SHËRBIMI
1	Pallat pa ashensor	Pastrim i ambienteve të përbashkëta (2herë/javë) ndriçim, mirëmbajtje e zakonshme, riparime të vogla, lyerje 1 (një) herë në 2 (dy) vjet	500 lekë
2	Pallat me ashensor	Pastrim i ambienteve të përbashkëta (2herë/javë) ndriçim, mirëmbajtje e zakonshme, riparime të vogla, lyerje 1 (një) herë në 2 (dy) vjet .	700 Lek

2. Efektet: Shërbim publik me rëndësi të veçantë për mirëmbajtjen e pronës së përbashkët, garantimin e sigurisë, funksionalitetit dhe kushteve të përshtatshme të jetesës për banorët.

3. Të ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administrata e Bashkisë Pogradec, dhe Administrata e Shoqërisë, Pogradeci Invest Shpk.

4. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

5. U shpall sot më datë 30.04.2026.

KRYETARË E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 18 vota

2. Vota Pro 18

3. Vota Kundër 4

4. Vota Abstenim 3

5. Zbardhur më date 30.04.2026